



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:190483

Datë: 14.05.2024

Numri i dokumentit: 05681836

A.nr.2213/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË—Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me sekretaren juridike Sanie Salihu, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, E.F. me vendbanim ..., në adresën ... kundër të paditurës, Dogana e Kosovës në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Krenare Shala-zyrtare në Doganën e Kosovës, duke vendosur sipas padisë së palës paditëse për anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2./6886 të datës 17.05.2022, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqës, me datë 15.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit ... me vendbanim në ..., si e pabazuar.

II. Mbetet në fuqi vendimi nr. 01.3.2.2./6886 të datës 17.05.2022, i të paditurës, Dogana e Kosovës.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës, Dogana e Kosovës, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 01.3.2.2./6886 të datës 17.05.2022, i të paditurës Doganës së Kosovës.

Më tej, paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, kërkon nga gjykata që të aprovohet padia tij si e bazuar dhe të anulohet vendimi i të paditës, ashtu që ti hiqet denimi me të cilën i është caktuar nga e paditura- Dogana e Kosoves, pasi që nuk ka mundësi të pageses së denimit. Thekson se, arsyeja e posedimit të telefonave, (3 copa) është se ka dy vendbanime, një në Bujanoc dhe tjetren në

Prishtine. Gjitashtu ka theksuar se, ka qenë duke i bartur nga një vendbanim në tjetrin, e jo për arsye të rishitjes, pasi nuk ka biznes, e nuk ka pasur shume telefona që të bëjë biznes, pra kan qenë vetem 3 telefona. Në fund thekson se, kërkon nga gjykata të lirohet nga detyrimet e importit duke u bazuar në dispozitat ligjore neni 3 dhe 49 te Kodit Doganor te Kosoves Nr.03/L-109.

E autorizuar e palës së paditura ka deklaruar se, mbetet ne tërësi pranë përgjigjes në padi dhe e kundërshton në tërësi padinë e paditësit, pasi qe vendimi i atakuar është marre konform dispozitave ne fuqi dhe ajo për te cilën pretendon paditësi se ky vendim është marre me shkelje ligjore nuk qëndron fare, se vendimi i atakuar është marr në mënyrë të drejt dhe konform legjislacionit ne fuqi, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta, në asnjë mënyrë nuk i ka vërtetuar as edhe me një prove të vetme juridike. Me tej, thekson se, si qytetar mallrat qe barten me bagazh privat u lejohet shuma deri 175 Euro për çdo udhëtar, përveç mallrat te cekura ne nenin 46 te KDA-se. Sa i përket mallrave për pajisje të vendbanimit të dytë, neni 20 deri 24 të KDA-se ka paraparë rrethanat se në cilat raste lirohen. Në fund ka theksuar se, nga shkresat e lëndës i propozon gjykatës që pas administrimit të provave të marr aktgjykim në të cilin të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, duke lënë ne fuqi aktvendimin e të paditurës.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: kopja e letërnjoftimit për ... e dt.16.04.2028; kopja e ID Kartelës për ...; Aktvendimi kontestues i dt.17.05.2022 me numër 01.3.2-6886; kopja e pasaportës te paditësit e dt. 18.04.2022; ankesadt.04.04.2022;Procesverbali mbi Kundërvajtjen Administrative Doganore i dt.28.03.2022 numër 03.1.7-2022-430-28.03.2022; Procesverbali i dt. 17.05.2022; e-maili – ankesa e dt.01.06.2022;dt.05.04.2022, e dt.04.04.2022.

Gjykata ne pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në ankesë, përgjigjen në padi, shkresat e lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe pasi vlerësoi provat veç e veç dhe të gjitha se bashku konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, Gjykata nga DUD-i kontestues, deklarimeve në ankesë, aktvendimi kontestues, ka nxjerr konstatimin se subjektit në procedurë ... fshati ...- ... i ka shqiptuar gjobën administrative në vlerë prej 500.00€, ku edhe i ka konfiskuar mallin lëndor telefona mobil 3 copë në vlerë prej 2.273.64€, sepse me datën 28.03.2022, rreth orës 10:00, në PKK Dheu i Bardhë, në hyrje është selektuar për kontroll të vijës së dytë fugoni me targa BU037CN, ku pas kontrollit në kabinën e fërgonit janë gjetur të padeklaruar tre telefona si një telefon IPHON 13

dhe dy telefona 13 ProMax në vlerën prej 2.273.64 €, ku sipas Sektorit për Kundërvajtje Doganore ky mall i subjektit në procedurë ... ka tentuar ti fusë në Kosovë pa i paguar detyrimet doganore, pra i njëjti- me veprimet e tij ka bërë shkelje duke mos paraqitur mallin pran autoritetit doganor, duke kryer kundërvajtje doganore nga neni 275 paragrafi a) duke i'u shmangur pagesës së taksës doganore. Për shkak të mos deklarimit të mallit me qëllim të shmangies së obligimeve doganore, paditësi është shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore ne bazë të nenit 276 a) të KDA-së si dhe si dhe ne baze te nenit 280 prag 1 i KDA-se është konfiskuar malli i padeklaruar i cili është objekt i kundërvajtjes doganore nga parag (a) i nenit 276 te KDA-se në vlere prej 2.273.64€.

Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues, për arsye se e paditura Dogana e Kosovës ka konstatuar se paditësi gjatë kalimit në PKK Dheu i Bardhë nuk e ka deklaruar mallin lëndor, mirëpo vetëm pas selektimit për kontroll nga zyrtaret doganor në bagazhin e tij (kabinën e fërgonit të tij) i është gjetur malli i cili është objekte i kundërvajtjes doganore ashtu siç është përshkruar Aneks nr. 03.1.7-2022-430/28.03.2022, në vlerë prej 2273.64€, me ç 'rast i është shmangur obligimeve doganore për deklarimin e mallit pranë doganës se Kosovës. Për shkak të mos deklarimit të mallit me qëllim të shmangies së obligimeve doganore, paditësi është shpallur përgjegjës për kundërvajtje doganore ne bazë të nenit 276 a) të KDA-së si dhe ne baze te nenit 280 prag 1 i KDA-se i është konfiskuar malli i padeklaruar i cili është objekt i kundërvajtjes doganore nga parag. (a) i nenit 276 te KDA-se në vlerën prej 2273.64€. Ashtu që gjykata ka pranuar si të bazuar qëndrimin juridik të paditurës të dhënë në vendimin kontestues edhe sa i përket nenit 250 par 2 te KDA-së, prandaj në këtë kuptim Gjykata nuk i ka pranuar si të bazuara pretendimet e paditësit për arsye se, paditësi ka dështuar që të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi, pasi që paditësi ne rastin konkret bartë detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi, ndërsa provat e paraqitura në Gjykate nuk janë me ndikim ne vendosjen ndryshe ne këtë çështje administrative.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje t'i kundërshtoj me argumente konstatimet e dhëna nga e paditura. Prandaj në këtë kuptim Gjykata nuk i ka pranuar si të bazuara pretendimet e paditësit për arsye se, paditësi është dashur që të provoj saktë me prova materiale argumentet dhe pretendimet e tij në padi, pasi që paditësi në rastin konkret bartë detyrimin e vërtetimit të pretendimeve në padi, ndërsa provat e paraqitura në Gjykatë nuk janë me ndikim ne vendosjen ndryshe në këtë çështje administrative.

Gjykata ka shqyrtuar bazën ligjore të cilën e ka aplikuar e paditura në vendimin kontestues, përkatësisht nenit 276 pika (a) te KDA-së parasheh se "*Personi juridik apo fizik, ne qofte se nuk paraqet mallin bazuar ne nenin 9 te Ligjit Nr. 04/L-099, për ndryshim plotësimin e KDAK Nr. 03/L-109, sipas te cilit për*

të gjitha shkelet e parapara te nenit 276 do te gjobiten ne te holla ne shume prej 500€ deri ne 10,000€, dhe ne këtë rast malli i cili është objekti i kundërvajtës doganore i kualifikuar ne dispozite e lartecekur do te konfiskohet kjo parashihet sipas neni 280 paraf 1 i KDA-se i thotë se: Malli i cili është objekt i shkeljes administrative nga neni 275, 276 a), b) dhe 278 do te konfiskohet. Andaj ne kontekst te gjendjes faktike dhe argumenteve ligjore këto dispozita ligjore i përgjigjen veprimet kundërvajtëse te paditësit, pasi qe veprimet e paditësit përbejnë te gjithat elementet e kundërvajtjes doganore te përshkruar ne vendimin kontestues. Nga arsyetimi i aktvendimit kontestues me të cilin paditësi është shpallur përgjegjëse për kryerje të kundërvajtjes doganore nga neni 276 paraf (a) të Kodit Doganor dhe te Akcizave te Kosovës, ekzistojnë të gjitha elementet e kryerjes së veprës kundërvajtëse, objekti i kundërvajtjes, dhe dispozita ligjore që sanksionon veprimet e kryera si në rastin konkret.

Gjykata nuk ka mundur ti merr për bazë pretendimet e paditësit, se paditësi nuk e ka dite se duhet te deklaroj mallin, për arsye se, paditësi ka mundur të dije dhe është dashur ta dije se mallin te cilin e ka poseduar është dashtë te deklaroj ne kufi ne hyrje te Kosovës para autoriteteve doganore pasi qe paditësi mban përgjegjësin për veprimet e tij, dhe mosdija nuk e liron paditësin nga përgjegjësia e kundërvajtjes doganore.

Gjykata nuk i aprovoi si të bazuara pretendimet e paditësit për të vlerësuar një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar në procedurën administrative. Në këtë rast për t'i vërtetuar pretendimet e veta në pajtim më dispozitat e nenit 81.F par.1 të Ligjit 04/L-102, paditësi është dashur t'i provoj me argumente faktet që e mbështesin kërkesën e tij, mirëpo as në procedurën administrative e as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që t'i provoj pretendimet e tij. Nga kjo gjendje gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se pretendimet e fakteve në këtë rast bien në barrë të paditësit i cili në këtë konflikt administrativ nuk ka paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin të kundërtën e konstatimeve nga vendimi kontestues.

Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejt. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi kontestues i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr.2213/2022, datë 15.04.2024

Gjyqtare
Luljeta Maxhuni

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.